



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1569 Prot.

Patos, më 11 / 05 / 2026

MIRATOHET
KRYETARI
Faton Durr

PROJEKTVENDIM

Nr. 22, datë 11 / 05 / 2026

PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE NGA “FONDI I KUSHTËZUAR I BUXHETIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE” PËR Z. PËLLUMB BENDAJ BANESA E TË CILIT ËSHTË DËMTUAR NGA RËNIA E ZJARRIT, LAGJJA “E RE”.

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, i ndryshuar pika 3.1 shkronja “a” të V.K.M-së nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” i ndryshuar, Planit Kombëtar për Emergjencat Civile të miratuar me VKM nr. 835, datë 3.12.2004, si dhe kërkesës së z. Pëllumb Bendaj me nr. 3360 prot., datë 06.11.2025, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare z. Pëllumb Bendaj për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë me vlerë 115,000 (Njëqindë e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
2. Vlera e kësaj ndihme do të mbulohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile 2026, **Kodi i produktit 91707 AB** “Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”

EKIPI I MENAXHIMIT TË PROGRAMIT

Të Sigurisë Publike

Drejtues Programi Arben **SHPËRDHEJA**

ANËTARË

Valbona **SEMANJAKU**

Alfred **GREMI** Alket **HALIMI** Erion **HATIJA**

Juriste
Joana **SHERIFI**



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E ZHVILLIMIT TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1569 / Prot.
14

Patos, më 11 / 105 / 2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE NGA “FONDI I KUSHTËZUAR I BUXHETIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN CIVILE” PËR Z. PËLLUMB BENDAJ BANESA E TË CILIT ËSHTË DËMTUAR NGA RËNIA E ZJARRIT, LAGJJA “E RE”.

Z.Pëllumb Bendaj ka paraqitur kërkesën me nr. 3360 prot., datë 06.11.2025, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në banesë në lagjen “E Re” nga rënia e zjarrit dhe për ndihmë financiare për rehabilitimin e saj. Për verifikimin e kërkesës së qytetarit është ngritur komisioni me urdhërin nr.165, nr.2649 prot., datë 01.09.2025 i përbër nga :

- | | |
|---------------------|---------|
| a. Ina Sauli | Kryetar |
| b. Çajup Refitaj | Anëtar |
| c. Arben Shpërdheja | Anëtar |
| d. Andi Kola | Anëtar |
| e. Ervis Ruçaj | Anëtar |
| f. Boreta Murati | Anëtar |
| g. Donald Xhafa | Anëtar |
| h. Ronaldo Banaj | Anëtar |
| i. Nurkë Hazizaj | Anëtar |

Komisioni pasi bëri verifikimin në vend të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e z. Pëllumb Bendaj mbajti procesverbalin me nr. 3360/1 prot., datë 14.11.2025.

Nga procesverbali i verifikimit në vend rezulton se janë djegur :

tavane rapote druri, dyer durali, dritare dural, parket (dyscheme), rrjeti elektik në një dhomë.

U hartuar edhe preventivi për punimet që duhet të kryhen në banesë në vlerën 235,169.99 (dyqindë e tridhjet e pesë mijë e njëqindë e gjashtëdhjet e nëntë pikë nëntëdhjet e nëntë) lekë, referuar edhe “Vërtetimit për rënie zjarri” nr. 6 të datës 06.11.2025 lëshuar nga MZSH Patos që vërteton rënien e zjarrit. Në bazë të V.K.M-së nr. 329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” të dëmtuarit i jepet ndihmë financiare 50% e vlerës.

Bazuar në V.K.M-në nr. 414, dt. 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen

civile” (i ndryshuar) pika 3.1 shkronja “a” me qëllim për të ndihmuar qytetarin Z. Pëllumb Bendaj, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, t’i jepet një ndihmë financiare në vlerën 115,000 (Njëqindë e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet:

Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Zhvillimit Territorit dhe Emergjencave Civile.

EKIPI I MENAXHIMIT TË PROGRAMIT

Të Sigurisë Publike

Drejtues Programi Arben SHPËRDHEJA

ANËTARË

Valbona SEMANJAKU

Alfred GREMI Alket HALIMI

Erion HATIJA

ZV. KRYETARE
Ina Sauli

